



TRANSPARENCA E BOTIMEVE ZYRTARE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

TRANSPARENCA E BOTIMEVE ZYRTARE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Realizuar nga:



Financuar nga:



Titulli i Raportit:

Transparenca e Botimeve Zyrtare
në Republikën e Shqipërisë, 2009

Botim i Qendrës për Çështjet e Informimit Publik, ÇIP



Website: www.infocip.org
e mail: qendra@cip-al.org

© copyright 2011 - Autori

grupi i punës:

Gerti Shella, drejtor projekti
Eniel Kolaneci, ekspert ligjor
Mirela Bogdani, ekspert ligjor
Anisa Papadhima, reserarcher
Ervin Doda, reserarcher
Besmira Naqellari, researcher

përkthimi:
Suzana Shehu
Eliona Balili

Redaktimi (shqip & anglisht):
Gerti Shella

design:
Anduena Manushi

* * *

u realizua në kuadër të projektit

“Monitoring the publication of the official acts of the state in the Official Journal,
exposing gaps and advocating e-publications”

financuar nga:



*Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve
dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit*

PERMBAJTJA

Kapitulli I. PUSHTETI LEGJISLATIV	8
Rezultatet e monitorimit, 2009, Ligje të Kuvendit	9
Kapitulli II. AKTET NDERKOMBETARE	10
Rezultatet e monitorimit, Teksti në shqip i akteve ndërkombëtare	11
Kapitulli III. PUSHTETI EKZEKUTIV	12
Rezultatet e monitorimit, 2009 VKM	13
Rezultatet e monitorimit, 2009, ANFL të KM	14
Rezultatet e monitorimit, 2009, Udhëzime të KM e ministrave	15
Udhëzime të Këshillit të Ministrave	16
Udhëzime të MF	17
Udhëzime të MASH	18
Udhëzime të MPPTT	19
Udhëzime të MMPAU	20
Udhëzime të MBUMK	21
Udhëzime të MD-MPÇSSHB-METE	22
Udhëzime të MSH	23
Tabelat e Udhëzimeve	24-25
Kapitulli IV. PUSHTETI GJYQESOR	26
Rezultatet e monitorimit, 2009, VUGJL	27
Rasti “Deliu”	28-29
Rezultatet e monitorimit, 2006-2008, VUGJL	30-31
Kapitulli V. GJYKATA KUSHTETUESE	32
Rezultatet e monitorimit, 2006-2009, Vendime te GJK	33
Kapitulli VI. GJYKATA EUROPIANE E TE DREJTAVE TE NJERIUT	34
Rezultatet e monitorimit, Vendime te GJUDNJ	35
Kapitulli VII. REKOMANDIME	36
Shkurt mbi metodologjinë	37
ANEKS SPECIAL NR.1, TABELAT E VKM-VE	38-51
ANEKS SPECIAL NR.2, TABELAT E AKTEVE NDERKOMBETARE	52-53

LISTA E SHKURTIMEVE

ANFL	- Akt Normativ me Fuqinë e Ligjit
AP	- Avokati i Popullit
FZ	- Fletore Zyrtare
GJEDNJ	- Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
GJK	- Gjykata Kushtetuese
GJL	- Gjykata e Lartë
KiE	- Këshilli i Europës
KM	- Këshilli i Ministrave
MASH	- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MBUMK	- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MD	- Ministria e Drejtësisë
METE	- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
MF	- Ministria e Financave
MMPAU	- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MPCSSHB	- Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta
MPPTT	- Ministria e Punëve Publike, Transport, Telekomunikacioneve
MSH	- Ministria e Shëndetësisë
QPZ	- Qendra e Publikimeve Zyrtare
VKM	- Vendim i Këshillit të Ministrave
VUGJL	- Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë



HYRJE

Raporti i Transparencës së Botimeve Zyrtare, vjen përpara publikut shqiptar dhe institucioneve të shtetit për të dytin vit radhazi. Ky raport monitorues për vitin 2009, u përgatit nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, ÇIP, falë mbështetjes së rëndësishme të dhënë nga National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C., që financohet nga Kongresi Amerikan.

Raporti i Transparencës së Botimeve Zyrtare, 2009 ka përfshirë në fokusin e monitorimit të gjithë spektrin e institucioneve qëndrore të shtetit shqiptar, sa i takon botimit të akteve të tyre në Fletoren Zyrtare. Për herë të parë, përmes këtij Raporti, ofrohet një panoramë e plotë e situatës së botimit të akteve zyrtare për institucionet përbërëse të treja pushteteve kushtetuese, Legjislativit, Ekzekutivit dhe Gjyqësorit. (Në raportin paraardhës, mbështetur nga OSFA, në fokus të monitorimit ishin vetëm botimi i ligjeve dhe akteve nënligjore të KM, 2006-2008. Falë ndihmesës së NED, në kuadër të Raportit aktual, ÇIP ka plotësuar më të dhënat e munguara edhe periudhën 2006-2008.)

Në kuadër të Raportit të Transparencës së Botimeve Zyrtare, 2009, ÇIP ka monitoruar edhe rregullsinë e botimit në Fletore Zyrtare të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të RSH, e cila ka një juridiksion të veçantë për kontrollin e kushtetueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera normative.

Po ashtu, ÇIP, për herë të parë, ka përfshirë në këtë raport edhe botimin në Fletore Zyrtare të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Botimi i tekstit të plotë të vendimeve të formës së prerë dhe vendimeve të tjera të GJEDNJ, me palë të paditur Shtetin shqiptar, është një praktikë që ndiqet nga Shqipëria në kuadër të Rekomandimit (2002) 13 të Komitetit të Ministrave të KiE. Vlen të theksohet se, sikurse implikon edhe vetë termi “Rekomandim”, botimi i vendimeve të GJEDNJ nuk është një detyrim ligjor që buron nga sistemi i brendshëm juridik i Republikës së Shqipërisë.

Autorët e këtij monitorimi, do të parapëlqenin ta konsideronin atë si një *raport audit* për sistemin e publikimeve zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Ky raport ka si *target* të natyrshëm Qendrën e Publikimeve Zyr-

tare, pa përjashtuar edhe të gjitha institucionet qëndrore, aktet e të cilave QPZ trajton për botim.

Gjithashtu, *target* po aq i natyrshëm i gjetjeve të këtij Raporti janë qytetarët shqiptarë. Qendra ÇIP, si një operator i shoqërisë civile i specializuar në fushën e monitorimit dhe transparencës së botimeve zyrtare, i përmbahet motos se **“Shqiptarët duhet ta dinë se çfarë ndodh në vendin e tyre”**. Aktet zyrtare janë një aset kombëtar me vlerë të pazëvendësueshme, dhe si të tilla ato duhet të jetë në përdorim dhe të aksesueshme prej të gjithë shqiptarëve. Për më tepër, shpallja e akteve zyrtare përmes botimit përbën një nga parimet themelore të shtetit. Ky parim afirmon kushtin që, përpara se të kërkohet respektimi i ligjit (normës) nga subjektet, këta duhet më së pari të njoftohen për këtë ligj.

ÇIP beson se, problemet e evidentuara në këtë Raport, mund të shërbejnë për të adresuar më mirë zgjidhjen e tyre nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Është me vend të theksohet se, institucionet e shtetit shqiptar kanë hedhur hapa shumë të rëndësishëm përpara për sa i takon publikimit të akteve zyrtare. Një punë të lavdërueshme ka bërë në këto dy vitet e fundit vetë QPZ, jo vetëm sa i takon procesimit për botim në Fletore Zyrtare të akteve që i dërgohen për botimi, por edhe për të pakësuar stokun e akteve të lëna jashtë botimi ndër vite. Edhe disa masa që janë duke u ndërmarrë së fundmi, edhe në kuadër të *e-governance*, i shërbejnë akoma më shumë përmirësimit të treguesve, duke demonstruar në këtë mënyrë seriozitet dhe përgjegjësi në kryerjen e funksionit të rëndësishëm shtetëror, sikurse është ai i botimit të akteve të shtetit.

Gjetjet e këtij Raporti i dorëzohen QPZ-së, për t’i botuar në numra ekstra të Fletores Zyrtare, pasi të ndërmarrë të gjitha verifikimet përkatëse mbi vërtetësinë e tyre. Në shpresojmë që ky raport i realizuar nga ÇIP, me ndihmesën e çmuar të NED në Washington D.C., të mund të konsiderohet si një kontribut i pavaruar që ndihmon në përpjekjen që QPZ është duke bërë prej dy vitesh tashmë, për reduktimin e “stokut” të akteve të mbetura jashtë botimi në FZ që nga viti 2000 e këtej.



1

PUSHTETI LEGJISLATIV

Shqipëria është një republikë parlamentare (neni 11 i Kushtetutës së Shqipërisë). Përgjithësisht, Kuvendi referohet ose identifikohet si institucioni më i lartë i shtetit. Megjithatë, Kushtetuta nuk ka ndonjë përkufizim për rolin dhe funksionet e Kuvendit apo për pozitën e epërme që ka ai në raport me organet e tjera kushtetuese¹.

Veprimtaria e Kuvendit të Shqipërisë rregullohet nga Rregullorja e Kuvendit, e cila miratohet nga vetë Kuvendi, sipas parimit të njohur dhe të aplikuar në vendet demokratike se “ligjvënasi (parlamenti) është zot i caktimit të rregullave të veta”².

Në ushtrim të pushtetit të tij ligjvënës, Kuvendi nxjerr disa lloje aktesh, mes të cilave ligje, vendime, rezoluta dhe deklarata. (Neni 106 i Rregullores së Kuvendit).

Nga të gjitha llojet e akteve që nxjerr Kuvendi, në fokus të këtij monitorimi do të jenë vetëm ligjet, të cilat qëndrojnë në majën e hierarkisë së dokumentave parlamentare. Ligjet janë qëllimi parësor dhe produkti përfundimtar i procesit ligjvënës. Si akt normativ, ligji përfaqëson një sistem normash juridike që rregullojnë në formë të përgjithshme, marrëdhënie shoqërore të rëndësishme.

Kushtetuta e Shqipërisë i ka kushtuar një rëndësi të posaçme procesit ligjvënës, ku një moment kyç është edhe mënyra e hyrjes në fuqi të ligjeve. Në pjesën e tretë të Kushtetutës, kreu IV, nenin 84/3 thuhet se: “ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare”. Kjo është edhe procedura e zakonshme e hyrjes në fuqi të ligjit.

Paragrafi 4 i nenit 84 parashikon edhe një procedurë të jashtëzakonshme të hyrjes në fuqi të ligjit dhe

konkretisht: “Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevoje dhe urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare”. Pra, që një ligj të hyjë në fuqi menjëherë duhet të plotësohen tre kushte kumulative:

- 1) Kuvendi të vendosë me shumicën e të gjithë anëtarëve;
- 2) Presidenti i Republikës të japë pëlqimin;
- 3) Ligji të jetë njoftuar publikisht.

Edhe neni 117 i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton në pikën 1 të tij se: “Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, ministrave, të institucioneve të tjera qëndrore marrin fuqi juridike vetëm pasi të botohen në Fletoren Zyrtare.”

Nga i gjithë parashtrimi i mësipërm, është e qartë se mos-botimi i ligjeve në Fletore Zyrtare do të shkaktojë *a-priori* mos-hyrjen e tyre në fuqi. Mos-botimi i akteve normative në Fletore Zyrtare, në kuptimin strikt juridik, do të thotë se ato nuk ekzistojnë³. Përderisa nuk ekzistojnë, ato nuk prodhojnë detyrim ndaj subjekteve për t’u zbatuar apo ndjekur prej tyre.

Parimi sipas të cilit *ignorantia juris non excusat* (injoranca ndaj ligjit nuk shfajëson (në gjykatë)), humbet kuptimin në një rast të tillë për shkak të mos-përmbljes së parimit që i paraprin, sipas të cilit “*nuk mund të përfitosh apo dëmtohesh nga një ndalim apo lejim i ligjit në rast se nuk ke mundësi reale apo formale të njohjes me ligjin*”. Botimi i ligjeve dhe akteve të tjera zyrtare në Fletore Zyrtare prezumon faktin që të gjithë njerëzit janë vënë në dijeni të këtyre akteve.

1. “E Drejta Kushtetuese” Luan Omari; Aurela Anastasi, ribotim 2010, fq.194

2. “E Drejta Kushtetuese” Luan Omari; Aurela Anastasi, ribotim 2010, fq.235

3. “E Drejta Administrative 2” Sokol Sadushi, botimi i tretë i ripunuar 2005, fq.55







Rezultatet e monitorimit, 2009

Ligje të Kuvendit të Shqipërisë


Në Fletore Zyrtare 2009 (1 Janar-31 Dhjetor), gjenden të botuara gjithsej 157 ligje.

Seria hapet me:  **Ligjin nr. 10055, datë 22.1.2009** “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për marrjen pjesë në financimin e projektit të furnizimit me ujë dhe të shërbimeve sanitare në Orikum....”
(botuar në Fletore Zyrtare nr 7, fq 121, data e botimit: 04-02-2009)

dhe mbyllet me:  **Ligjin nr. 10211, datë 23.12.2009** “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e funksionimit dhe burimet e financimit të sistemit të tachograph digital në Shqipëri”,
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 194, Faqe 8582; data e botimit: 20-01-2010;).

Nga shqyrtimi i Fletores Zyrtare 2009, rezultoi:

gjatë vitit 2009, janë botuar në Fletore Zyrtare të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi

Konstatime ekstra:  Nga totali prej 157 ligjesh të miratuara dhe të botuara në Fletore Zyrtare, 2009, plot 11 prej tyre kanë të përcaktuar në dispozitën e fundit se “hyjnë në fuqi menjëherë”. Nga verifikimi rezultoi se, për këto 11 ligje, janë përmbushur rigorozisht tre kushtet kumulative që parashikohen në Kushtetutë, në mënyrë që ato të hyjnë në fuqi menjëherë, konkretisht:

- 1) Kuvendi ka vendosur me shumicën e të gjithë anëtarëve;
- 2) Presidenti ka dhënë pëlqimin me dekret të posaçëm për hyrjen në fuqi menjëherë;
- 3) ligji është njoftuar publikisht;

Konstatohet se, për ligjet nr 10100, 10101, 10102, 10103 dhe 10104 (që kanë të bëjnë me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO), miratimi nga Kuvendi, shpallja me dekret nga Presidenti (përfshirë dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë) dhe botimi në Fletore Zyrtare janë bërë në të njëjtën datë, konkretisht në dt. 23/6/2009.

Kurse për ligjet 10121, 10122, 10123, 10124, 10125 dhe 10126, miratimi nga Kuvendi është bërë në datë 11.5.2009, shpallja me dekret nga Presidenti (përfshirë dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë) është bërë në datë 13.5.2009, kurse botimi në Fletore Zyrtare është bërë në datë 14.5.2009. Të gjashta ligjet në fjalë ratifikojnë marrëveshje huaje ose kredie mes qeverisë shqiptare dhe bankave evropiane (CEBD, BRD, UNICREDIT BANK AUSTRIA, ALPHA BANK A.E. E DEUTSCHE BANK, DEGA E LONDRËS).



2

MARREVESHJET NDERKOMBETARE

Kushtetuta e Shqipërisë i ka kushtuar një vëmendje të posaçme procesit të lidhjes së traktatave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Në pjesën e parë të saj, “Parime Themelore”, ajo përcakton se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të” (Neni 5).

Në fushën e të drejtave të njeriut, Kushtetuta ka futur drejtpërdrejtë në veprim Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, duke e ngritur në nivelin e normës kushtetuese teksa thekson se “kufizimet e të drejtave dhe lirive nuk mund të tejkalojnë në asnjë rast kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut” (neni 17/2).

Marrëveshjet ndërkombëtare renditen të dytat pas Kushtetutës në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 116/1). Botimi i tekstit të tyre është detyrim kushtetues dhe ligjor pasi, në bazë të nenit 117/3 të Kushtetutës: “Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit”.

Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë... (neni 122/1). Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të (neni 122/2).

Në mënyrë që të mundësohet zbatimi i një marrëveshjeje, sipas kuptimit të Kushtetutës, është e domosdoshme që, njësoj si edhe për ligjet, përmbajtja e këtyre akteve t’i bëhet e njohur në gjuhën shqipe (*deduksion logjik*) organeve të shtetit shqiptar si dhe të gjithë shtetasve shqiptarë.

Në fakt, gjatë punës së tij, Avokati i Popullit (AP) ka konstatuar se një numër relativisht i madh aktesh ndërkombëtare që Shqipëria ka nënshkruar apo ka

aderuar, para dhe pas viti 1990, nuk janë ende të botuara në Fletore Zyrtare.

Vlen të përmendet mungesa e botimit në FZ të asaj që mund të konsiderohet si konventa e parë e OKB, ratifikuar nga parlamenti pluralist pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri, pikërisht Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e OKB.

Sipas AP, deri në vitin 2002, nga 47 Konventa, Marrëveshje, apo Protokolle të Këshillit të Europës të ratifikuara nga pala shqiptare, për 25 prej tyre nuk ekzistonte i botuar në Fletore Zyrtare teksti i përkthyer në shqip. Ndërsa, nga rreth 87 akte të OKB të ratifikuara nga Kuvendi, për rreth 50 prej tyre nuk është botuar asnjëherë teksti i përkthyer në shqip. Në vitin 2008, në Raportin Special nr.1 adresuar Kuvendit, AP konstatonte se problemi vijonte të mbetej i pazgjidhur për këto 75 akte ndërkombëtare të identifikuara që në vitin 2002.

AP, çmonte se “është shumë i rëndësishëm botimi i teksteve të të gjitha akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, para dhe pas vitit 1990, të cilat janë bërë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm dhe, si rrjedhim, janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga institucionet e shtetit shqiptar, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë”.

Duke e njohur dhe pranuar si të mirëqenë problemin në fjalë, Qendra ÇIP ka përfshirë në këtë raport edhe gjetjet për botimin (ose jo) në FZ Ekstra të teksteve në gjuhën shqipe të këtyre 75 akteve ndërkombëtare, të cilat AP i ka identifikuar si “stok” i pabotuar në Raportin Special nr.1, dt 23.05.2008.

Ndërkohë, ÇIP ka monitoruar me kujdes ecurinë e botimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nga Kuvendi gjatë vitit 2009. Në kuadër të këtij raporti do të paraqiten edhe të dhënat e botimit në FZ 2009 të tekstit shqip të akteve ndërkombëtare të ratifikuara gjatë 2009-ës.





Rezultatet e monitorimit

Teksti në shqip i akteve ndërkombëtare

Praktika sugjeron se aktet “stok” të pabotuara, trajtohen për botim në FZ Ekstra. Meqënëse, Raporti Special nr.1 i AP mban datën 23/05/2008, atëherë ÇIP u fokusua në hulumtimin e të gjitha FZ Eksta të nxjerra që nga 2008-a (7 gjithsej) e deri në fund të 2009-ës (6 gjithsej).

Nga hulumtimi një për një i tyre, rezulton të jetë botuar në gjuhën zyrtare shqipe vetëm teksti i Konventës “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (OKB). Botimi i saj është bërë në FZ Ekstra 33, dt. 15/10/2008, pra rreth 5 muaj pas dërgimit në Kuvend të Reportit Special Nr.1 nga AP.

Rreth 15 ditë para se të dorëzohej në Kuvend ky Raport, QPZ botoi në FZ Ekstra 28 dhe 29 tekstin shqip të “Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të KE, së bashku me të gjitha

protokollet shtesë të saj (15 në total).

Edhe pse studimi i ndërmarrë nga AP konkludoi në 75 akte ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, që janë akoma të pabotuara në shqip në FZ, vetë Qendra ÇIP nuk merr përsipër certifikimin 100% të vërtetësisë së kësaj shifre, sa kohë që ndaj këtij “stoku” nuk është aplikuar metodologjia e saj e verifikimit.

Megjithatë, në *Aneksin Special nr. 2* të këtij raporti monitorues, në Tabelën Nr.8 dhe Nr.9, ÇIP ka grupuar rreth 22 akte ndërkombëtare, të ratifikuara pas ‘90-ës dhe të identifikuar nga AP si të pabotuara në shqip, për të cilat është bërë një aplikim pjesor i Metodologjisë “ÇIP” dhe që për të cilat, u konkludua se realisht nuk gjenden të botuara në Fletore Zyrtare, sikurse është pohuar edhe më parë nga AP në **Raportin Special nr. 1**.

Si konkluzion, mund të thuhet se, deri në fund të 2009-ës, nga “stoku” i identifikuar nga AP, janë botuar vetëm:

1 Konventë e OKB-së

15 Konventa, Marrëveshje, apo Protokolle të KE



Nëse reduktimi i “stokut” të marrëveshjeve ndërkombëtare, teksti i të cilave nuk është botuar akoma në FZ, konsiderohet si një problem që nuk ka marrë akoma zgjidhje të plotë, botimi i tekstit në shqip të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara gjatë vitit 2009 paraqet një panoramë krejt tjetër.

Nga hulumtimi i FZ 2009, rezultojnë të botuara 38 ligje që ratifikojnë marrëveshje ndërkombëtare (8 aderim në konventa dhe 30 nënshkrim/aderim marrëveshjesh ndërkombëtare). Të 38-ta këto ligje janë të botuara në FZ, bashkëshoqëruar nga teksti i marrëveshjes i përkthyer zyrtarisht në shqip.

Si konkluzion:

gjatë 2009-ës, janë botuar në FZ të gjitha tekstet shqip të marrëveshjeve ndërkombëtare që ka ratifikuar me ligj Kuvendi i Shqipërisë



3

PUSHTETI EKZEKUTIV

Pushteti ekzekutiv në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga një tërësi organesh qëndrore ose vendore, në krye të cilave qëndron Këshilli i Ministrave. Ai përbëhet nga Kryeministri, Zv.Kryeministri dhe nga Ministrat (neni 95 i Kushtetutës).

Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesorë të politikës së përgjithshme shtetërore. Në ushtrim të pushtetit të vet ekzekutiv, ai nxjerr vendime dhe udhëzime (Neni 100 i Kushtetutës). Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme (neni 101 i Kushtetutës).

Aktet normative të Këshillit të Ministrave kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; ato renditen të katërtat në hierarkinë e akteve, konkretisht pas Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve (neni 116 i Kushtetutës).

Pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave është *propozimi i projektligjeve* (neni 81 i Kushtetutës) edhe *miratimet në parim të marrëveshjeve ndërkombëtare*. Të dyja këto lloj aktesh i dërgohen Kuvendit respektivisht për miratim, ose ratifikim (kur ratifikimi kërkohet nga dispozitat ligjore në fuqi). Këshilli i Ministrave ka gjithashtu kompetencë të lidhë marrëveshje të cilat nuk janë objekt ratifikimi nga Kuvendi.

Këshilli i Ministrave kryesohet nga kryetari i Këshillit të Ministrave (rëndom: *Kryeministri*). Kushtetuta i ka rezervuar një pozicion epërsie këtij të fundit në ushtrimin e funksioneve të drejtimit politik. Neni 102/1 gërma b sanksionon se “kryeministri koncepton dhe paraqet drejtimit kryesorë të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to”.

Kryeministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr

urdhra, kurse ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime. (neni 102/ pika 3 & 4, i Kushtetutës).

Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Ministrave rregullohet me ligjin organik nr. 9000, dt. 30. 1. 2003. Ky ligj i kushton një rëndësi të posaçme në *kreun IV* të tij llojeve të akteve që nxjerrin organet qeveritare, mënyrës së hyrjes në fuqi dhe botimit të tyre në Fletore Zyrtare. Sipas nenit 29 të këtij ligji:

1. *Aktet normative, me fuqinë e ligjit, të Këshillit të Ministrave botohen menjëherë në Fletoren Zyrtare.*
2. *Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare.*
3. *Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare.*
4. *Urdhrat e Kryeministrit, të ministrit ose të drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, hyjnë në fuqi menjëherë, u njoftohen të interesuarve dhe shpallen, për të paktën 3 ditë, në një vend të dukshëm të institucionit përkatës.*

Kjo do të thotë se, me përjashtim të *Urdhrave* (pika 4, neni 29), botimi i çdo akti të Këshillit të Ministrave dhe/apo ministrave në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm me ligj në çdo rast. Ligjvënësi është kujdesur që detyrimi ligjor për botimin në Fletore Zyrtare të akteve që nxjerr Këshilli i Ministrave (neni 29, ligji 9000) të mos lidhet domosdoshmërisht vetëm me caktimin e momentit të hyrjes në fuqi të aktit (sikurse do të ishte rasti për aktet me karakter normativ).





Rezultatet e monitorimit, 2009

Vendime të Këshillit të Ministrave, VKM

Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) indeksohen nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do të thotë se seria e aktit hapet në fillim

të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr VKM e fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor).

Seria e VKM-ve për 2009-ën hapet me:



Vendim Nr 1 Datë 07-01-2009 - Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve

Fletorja Zyrtare: Viti 2009, Nr 1, Faqe 3; Data e botimit: 12-01-2009;

dhe mbyllet me:



Vendim Nr 1305 Datë 29-12-2009 - Për disa shtesa në Vendimin nr.1253, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të vlerësimit për dëmshpërblimin e përfutur nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist"

Fletorja Zyrtare: Viti 2009, Nr 197, Faqe 8743; Data e botimit: 02-02-2010;

Rregulli i përgjithshëm që aplikohet në indeksimin e VKM-ve në këtë rast sugjeron se Këshilli i Ministrave ka miratuar të paktën 1305 VKM gjatë vitit 2009. Nga ballafaqimi i kujdesshëm i përmbajtjes së Fletores Zyrtare 2009 (lloji i aktit: VKM) me përmbajtjen e faqes zyrtare në internet të KM, u identifikuan fillimisht 165 VKM që ishin në websitin zyrtar, por nuk rezultoi në botuara në Fletore Zyrtare 2009.

Në gusht 2010, rreth një muaj pasi ÇIP kishte arritur në rezultatin e mësipërm, QPZ botoi në 6 Fletore

Zyrtare Ekstra (63, 64, 65, 66, 67, 68), plot 138 VKM të miratuar që në vitin 2009. Prej këtyre, 70 VKM përkonin me një pjesë të atyre të identifikuar nga ÇIP përmes ballafaqimit të përmbajtjes së faqes zyrtare të KM me atë të Fletores Zyrtare. Diferenca prej 68 të tjerash ishin VKM të cilat, përveçse të pabotuar në FZ 2009, nuk rezultoi në publikuara as në faqen zyrtare të KM. Këto sigurisht që i shtohen rezultatit prej 166 VKM-sh që ÇIP konkludoi se mungonin në Fletore Zyrtare 2009, disa javë përpara se QPZ të bonte Fletoret Zyrtare Ekstra në verën e vitit 2010.

Si konkluzion:

gjatë vitit 2009, nuk janë botuar në Fletore Zyrtare: më e pakta 95 VKM

janë botuar në Fletore Zyrtare Extra, me rreth 1 vit vonesë, plot 138 VKM

Më e shumta teorike do të ishte rreth 246 VKM të pabotuara, në rastin e supozuar që gjatë vitit 2009, Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar asnjë vendim me karakter "sekret" (shih: *Shkurt mbi Metodologjinë*).

Për shkak të volumit relativisht të lartë, tabela e VKM të identifikuar si të pabotuar në Fletore Zyrtare 2009, paraqitet të renditura në një tabelë të posaçme (Tabela Nr.7), me të gjitha specifikimet e nevojshme, në Aneksin Special nr. 1 të këtij raporti, faqe 38.





Rezultatet e monitorimit, 2009

Akte normative me fuqinë e ligjit, KM

Neni 101 i Kushtetutës, parashikon rastin kur Ekzekutivi merr attribute të Legjislativit, në mënyrë që “në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve”.

Hyrja në fuqi menjëherë e akteve normative me fuqinë e ligjit (për nga vetë natyra e aktit që nxirret në kushte nevoje dhe urgjence, pra kur “puna nuk pret” që të mbledhet Kuvendi për të nxjerrë ligj), implikon një çështje mjaft sensitive, sa kohë që e lë të hapur diskutimin se çfarë ndodh me pasojat e prodhuara menjëherë nga ky akt nëse Kuvendi e rrëzon (nuk e miraton) atë brenda 45 ditëve. As doktrina dhe as praktika kushtetuese në Shqipëri nuk kanë përcaktuar akoma se çfarë duhen konsideruar “raste nevoje dhe urgjence”.

Në kuadër të këtij raporti, nuk do të ndalemi në diskutimin doktrinar mbi mënyrën e hyrjes në fuqi të aktit normativ me fuqinë e ligjit, për të cilin Gjykata Kushtetuese ka të paktën dy interpretime të saj.

Një gjë është e sigurtë: botimi i menjëhershëm në Fletoren Zyrtare i aktit normativ me fuqinë e ligjit është një kërkesë që rrjedh nga pika 1, neni 29, Ligji Nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, e cila përcakton shprehimisht se: “Aktet normative, me fuqinë e ligjit, të Këshillit të Ministrave botohen menjëherë në Fletoren Zyrtare”.

Aktet normative me fuqinë e ligjit të KM, indeksohen nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do të thotë se seria e aktit hapet në fillim të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr ANFL e fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor).

Seria e ANFL për 2009-ën hapet me:



Aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 1, datë 02-04-2009 “Për dërgimin e një kompanie të forcave të armatosura në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qëndrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë në misionin “MINUR-CAT” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
(botuar në Fletore Zyrtare nr.38, fq 2011, Data e botimit: 03-04-2009)

dhe mbyllet me:



Aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 10, datë 23-12-2009 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar”.
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 187, Faqe 8285; Data e botimit: 31-12-2010;).

Nga verifikimi rezultoi se vargu indeksues për këtë lloj akti nuk ka mungesa, që do të thotë se:

në Fletore Zyrtare, 2009 janë të botuar të gjitha aktet normative me fuqinë e ligjit të KM.





Rezultatet, 2009

Udhëzime të KM dhe ministrave

Udhëzimi është akti juridik që nxirret në bazë e për zbatim të ligjeve. Ai është një akt me karakter normativ që detajon, sygjeron dhe këshillon, nëpërmjet orientimeve të shtjelluara e të zbërthyer me hollësi, të gjitha urdhërimet që ka vendosur ligji. Udhëzimi ka karakter sqarues, por kjo nuk duhet marrë dhe as interpretuar në kuptimin e ngushtë të emërtimit të tij, sikur ai nuk mund të sjellë efekte detyruese për subjektet e së Drejtës Administrative. Organet përkatëse të administratës si dhe personat të cilëve iu drejtohet urdhëzimi, janë të detyruar të zbatojnë me përpikmëri rregullat që ai vendos për marrëdhënien konkrete që parashikon. Sigurisht që, efektet detyruese të normave të udhëzimit nuk janë të së njëjtës shkallë me normat juridike të vendimit, urdhëresës ose rregullores. Megjithatë, normat juridike që parashikon udhëzimi janë norma të një akti juridik dhe si të tilla, mbeten të detyrueshme për t'u zbatuar¹. E drejta për të nxjerrë udhëzim i përket vetëm organit që i është njohur shprehimisht një e drejtë e tillë. Sipas Kushtetutës (neni 100/5 & 102/4), udhëzimi nxirret vetëm nga Këshilli i Ministrave dhe ministri². Për shkak të karakterit të tij normativ, udhëzimi hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare, konform përcaktimit të nenit 117 të Kushtetutës sipas të cilit "Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qëndrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare".

Në respekt të normës kushtetuese, Ligji Nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", përcakton qartë përmes nenit 29, paragrafi 3, se: "Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare".

Botimi i akteve normative që nxjerrin Këshilli i Ministrave dhe ministrat është gjithashtu detyrim ligjor për QPZ. Neni 2, gërma "a" e ligjit nr.8502, datë 30.6.1999, i ndryshuar, "Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare", përcakton shprehimisht detyrimin e Qendrës për botimin e "akteve normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qëndrore...". Nga i gjithë parashtrimi i mësipërm, është e qartë se botimi në FZ i udhëzimeve të KM dhe ministrave, është një detyrim kushtetues dhe ligjor (ligji 9000 dhe ligji 8502) dhe kusht për hyrjen e tyre në fuqi. Në kuadër të këtij monitorimi do të paraqiten gjetjet për udhëzimet që nxirren nga:

1. Këshilli i Ministrave
2. Ministria e Financave
3. Ministria e Arsimit
4. Ministria e MPPTT
5. Ministria e Bujqësisë
6. Ministria e Mjedisit
7. Ministria e Drejtësisë
8. Ministria e Ekonomisë
9. Ministria e Shëndetësisë
10. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale...

Udhëzimet e përbashkëta do të përlloragiten vetëm kur rezulton se kanë sistem të qartë indeksimi.

Përveç vitit 2009, periudha kohore të cilën do të mbulojë ky monitorim përfshin edhe vitet 2006-2007-2008. Gjetjet për këtë trevjeçar synojnë të plotësojnë me të dhëna monitorimin e realizuar një vit më parë nga Qendra ÇIP, mbështetur nga OSFA, objekt i të cilit ishin vetëm ligjet dhe VKM, por jo udhëzimet e ministrave.



*Neni 29, paragrafi 3,
Ligji Nr.9000,
"Për organizimin dhe
funksionimin e KM*

1 - "E Drejta Administrative 2" Sokol Sadushi, botimi i tretë i ripunuar, 2005, fq.61

2 - "E Drejta Administrative 2" Sokol Sadushi, botimi i tretë i ripunuar, 2005, fq.62





Udhëzime të Këshillit të Ministrave (KM)

Këshilli i Ministrave nxjerr çdo vit një numër relativisht të ulët udhëzimesh, të cilat indeksohen, sikurse dhe VKM-të, nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike.

Kjo do të thotë se seria e aktit hapet në fillim të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri

rendor që merr udhëzimi i fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor).

Nga hulumtimi një për një i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2009, rezultojnë të botuara vetëm dy udhëzime të Këshillit të Ministrave, konkretisht:



Udhëzim Nr 1 Datë 01-04-2009 - Për formën, mënyrat e procedurat e raportimit të dhënave të subjekteve, agjencisë së legalizimit, urbanizimit dhe integritit të zonave/ndërtimeve informale dhe zyrës qendrore të rregjistrimit të pasurive... (botuar në Fletore Zyrtare Nr 69, Faqe 3143; Data e botimit: 21-05-2009);



Udhëzim Nr 2 Datë 08-04-2009 - Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi. (botuar në Fletore Zyrtare Nr 48, Faqe 2373; Data e botimit: 24-04-2009);

Këto dy udhëzime gjenden të publikuara edhe në sitin zyrtar të Këshillit të Ministrave. Nuk rezultojnë të dhëna (në sitin zyrtar të KM, në raporte, strategji etj) që të indikojnë ekzistencën e ndonjë udhëzimi tjetër që do kishte nr. indeksues më të madh se "2", çka do të influenconte rezultatin e verifikimit *Skematik*, që konsiston në identifikim e mungesave në vargun indeksues (*shih : Shkurt mbi Metodologjinë*).

Vlen të theksohet se në websitin zyrtar të KM publikohen me një rregullsi të kënaqshme aktet e miratuara nga ky institucion, ndërkohë që websitet

zyrtare të ministrave kanë mangësi serioze në këtë drejtim.

Në kuadër të verifikimit të botimit në Fletore Zyrtare të udhëzimeve, ato të KM janë të vetmet për të cilat mund të ushtrohet edhe verifikimi *Faktik*, që konsiston në ballafaqimin e të dhënave që publikohen në të paktën dy burime zyrtare, në rastin konkret, në Fletore Zyrtare dhe në websitin zyrtar.

Si verifikimi *Skematik* ashtu dhe ai *Faktik* sugjerojnë në këtë rast të njëjtin rezultat, pra që:



gjatë vitit 2009, janë botuar në Fletore Zyrtare të gjitha udhëzimet e Këshillit të Ministrave





Udhëzime të Ministrisë së Financave (MF)

Ministri i Financave nxjerr çdo vit një numër relativisht të lartë udhëzimesh, krahasuar me ministrat e tjerë të kabinetit qeveritar. Udhëzimet e Ministrisë së Financave, indeksohen, sikurse dhe VKM-të nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo

do të thotë se seria e aktit hapet në fillim të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr udhëzimi i fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor). Seria e udhëzimeve të MF për vitin 2009 hapet dhe mbyllet respektivisht me:



Udhëzim Nr 1, Datë 08-01-2009¹ - Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive.
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 2, Faqe 15; Data e botimit: 15-01-2009);



Udhëzim Nr 52 Datë 28-12-2009 - Për përcaktimin e procedurave dhe afateve për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 189, Faqe 8334; Data e botimit: 08-01-2010);

Në Fletore Zyrtare, 2009 rezultojnë të botuara *de-facto* vetëm 33 udhëzime të MF. Ndërkohë, nga hulumtimi i kujdesshëm i websitit të Ministrisë së Financave, por edhe i dokumentave të tjerë qeveritarë që gjenden *online* (raporte, strategji etj), janë identifikuar konkretisht 8 udhëzime të nxjerra gjatë 2009-ës, të cilat janë pjesë e stokut të udhëzimeve që nuk janë botuar në Fletore Zyrtare. Mes tyre, gjenden 4 udhëzime të cilat kanë indeks të fraksionuar, konkretisht 20/1, 20/2, 20/3 dhe 27/1.

Këto lloj udhëzimesh janë si rregull përmirësime apo ndryshime që i bëhet një udhëzimi konkret paraardhës, konkretisht në rastin tonë atij me Nr. 20 dhe 27. Kjo do të thotë se gjatë vitit 2009, MF ka nxjerrë të paktën 56 udhëzime (52 me indeks të thjeshtë + 4 me indeks të fraksionuar), prej të cilave janë botuar vetëm 33.

Në tabelën me kutiza, jepet një paraqitje vizive e mungesave që konstatohen në vargun indeksues të udhëzimeve të ministrit të Financave.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
20/1	20/2	20/3	21	22	23	24	25	26	27
27/1	28	29	30	31	32	33	34	35	36
37	38	39	40	41	42	43	44	45	46
47	48	49	50	51	52				

Me portokalli janë ngjyrosur kutizat të cilat indikojnë udhëzime që nuk janë botuar në Fletore Zyrtare.

Me të verdhë janë ngjyrosur kutizat që indikojnë ato udhëzime që nuk janë botuar, të cilat janë identifikuar nga ÇIP edhe si titull dhe/ose si përmbajtje. (shih: Tabela Nr.1).

Si konkluzion, ashtu sikurse sugjerojnë edhe kutizat e ngjyrosura,

në Fletore Zyrtare 2009, nuk janë botuar të paktën 23 udhëzime të MF ose 44.2% e totalit

1- Një ditë para firmosjes së udhëzimit nr 1, pikërisht në datë 07-01-2009, ministri i Financave ka firmosur një udhëzim që mban nr 26-2 "PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 4.9.2008" PËR TAKSAT KOMBËTARE". Edhe pse si rregull ky udhëzim do të duhet të indeksohet me nr 1 dhe rrjedhimisht të haptë serinë e udhëzimeve për 2009-ën, në kuadër të këtij monitorimi kjo nuk do të konsiderohet si parregullsi, sa kohë që nuk ka një udhëzim 26 dhe 26-1 respektivisht në dt 04-09-2008 dhe 20-11-2008, pra në fund të vitit paraardhës). Gjithashtu, udhëzimet e përbashkëta në të cilat iniciuese është vetë MF dhe kundërsigues janë ministri të tjera të linjës, do të konsiderohen si të ishin pjesë e të njëjtit varg numerik që indeksin udhëzimet e thjeshta.





Udhëzime të Ministrisë së Arsimit (MASH)

Edhe ministri i Arsimit dhe Shkencës, ashtu sikurse ai i Financave nxjerr një numër relativisht të lartë udhëzimesh brenda harkut kohor të një vitit, krahasuar kjo me ministrinë e tjera. Udhëzimet e Minis-

trisë së Arsimit dhe Shkencës, indeksohen gjithashtu, nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Në Fletore Zyrtare, 2009 rezultojnë të botuara vetëm 3 udhëzime të MASH, konkretisht:



Udhëzimi Nr 20 Datë 29-07-2009 "Për disa ndryshime në shtojcën 1 të udhëzimit nr.5, datë 22.1.2008 "Për përcaktimin e standarteve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës..."
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 134, Faqe 6256; Data e botimit: 11-09-2009);



Udhëzimi Nr 21 Datë 30-07-2009 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë"
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 134, Faqe 6257; Data e botimit: 11-09-2009);



Udhëzimi Nr 24 Datë 02-09-2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 26.9.2007 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve..."
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 141, Faqe 6414; Data e botimit: 02-10-2009);

Edhe pse Udhëzimi nr 24 i MASH përfaqëson aktin me indeksin më të lartë në Fletore Zyrtare 2009, në faqen zyrtare të internetit të MASH gjendet i publikuar, ndër të tjera, Udhëzimi nr.41, dt. 08.12.2009, "Për procedurat e njohjes së diplomave dhe certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja". Ky udhëzim përfaqëson *de-facto* aktin me numrin indeksues më të lartë, dhe, nisur edhe nga data e miratimit të tij, ka shumë mundësi që të jetë pikërisht ky udhëzim që mbyll serinë e 2009-ës. Kjo përcakton *de facto* edhe nivelin "tavan", tek i cili bazohen përlogaritjet e verifikimit **Skematik**.

Kjo do të thotë që gjatë vitit 2009, MASH ka nxjerrë të paktën 41 udhëzime, prej të cilave vetëm 3 gjenden të botuara në Fletore Zyrtare.

Nga kqyrja e kujdesshme e websitit të MASH, por edhe e dokumentave të tjerë qeveritarë që gjenden on-line (raporte, strategji, gazeta "Mësuesi" etj), janë identifikuar konkretisht 15 udhëzime të nxjerra gjatë 2009, të cilat janë pjesë e stokut të udhëzimeve që nuk janë botuar në Fletore Zyrtare 2009. Në tabelën me kutiza, jepet një paraqitje vizive e këtyre mungesave që konstatohen në vargun indeksues:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41									

Me portokalli janë ngjyrosur kutizat të cilat indikojnë udhëzime që nuk janë botuar në Fletore Zyrtare.

Me të verdhë janë ngjyrosur kutizat që indikojnë ato udhëzime që nuk janë botuar, të cilat janë identifikuar nga ÇIP edhe si titull dhe/ose si përmbajtje. (shih: Tabela Nr.1).

Si konkluzion, ashtu sikurse sugjerojnë edhe kutizat e ngjyrosura,

në Fletore Zyrtare 2009, nuk janë botuar të paktën 38 udhëzime të MASH ose 73% e totalit







Udhëzime të Ministrisë së Transporteve (MPPTT)

Ministria e Punëve Publike, Transportit, Telekomunikacioneve rezulton se nxjerr një numër relativisht të vogël udhëzimesh brenda një viti. Udhëzimet e kësaj ministrie indeksohen gjithashtu, nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do

të thotë se seria e aktit hapet në fillim të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr udhëzimi i fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor). Seria e udhëzimeve të MPPTT për vitin 2009 hapet dhe mbyllet respektivisht me:

-  Udhëzim Nr 1 Datë 28-01-2009 - Për pajisjen me certifikatën e kompetencës profesionale të drejtuesit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor (botuar në Fletore Zyrtare Nr 13, Faqe 941; Data e botimit: 20-02-2009);
-  Udhëzim Nr 11 Datë 18-12-2009 - Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr. 15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", të ndryshuar (botuar në Fletore Zyrtare Nr 182, Faqe 8114; Data e botimit: 24-12-2009);

Të botuara në Fletore Zyrtare, 2009 gjenden vetëm 6 udhëzime të ministrit të MPPTT, kurse 5 të tjera i mungojnë "apelit" në vargun indeksues, ose, e thënë ndryshe, nuk janë botuar në Fletore Zyrtare. Ndërkohë, përmes verifikimi Faktik, është identifi-

kuar vetëm 1 udhëzim i 2009-ës, që është pjesë e këtij stoku prej 5 udhëzimesh të pabotuara në Fletore Zyrtare. Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje vizive e mungesave të cilat konstatohen në vargun indeksues të udhëzimeve të kësaj ministrie:

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11									

Portokalli: udhëzime që nuk janë botuar në FZ.
Të verdhë: udhëzime të pabotuara, por të identifikuar.
 (shih Tabelën Nr.1) .

Si konkluzion, ashtu sikurse sugjerojnë edhe kutizat e ngjyrosura,

në Fletore Zyrtare 2009, nuk janë botuar të paktën 5 udhëzime të MPPTT ose 45.4% e totalit





Udhëzime të Ministrisë së Mjedisit (MMPAU)

Ministria e Mjedisit, Mbrojtjes së Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, rezulton se nxjerr një numër të vogël udhëzimesh brenda një viti. Udhëzimet e kësaj ministrie indeksohen gjithashtu, nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do të thotë se seria e aktit hapet në fillim të çdo viti me

numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr udhëzimi i fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor). Nga hulumtimi një për një i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2009, gjendet i botuar vetëm një udhëzim, konkretisht:



Udhëzimi Nr 2 MMPAU Datë 14-05-2009 - Për kriteret e konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor (botuar në Fletore Zyrtare Nr 64, Faqe 2912; datë 14-05-2009);

Rasti në fjalë sugjeron se në Fletore Zyrtare 2009 nuk është botuar udhëzimi me numër indeksues 1, i cili hap serinë për vitin 2009.

Udhëzim Nr. 1, datë 3.3.2009 "Për Detyrat e Organeve Mjedisore për të Siguruar Pjesëmarrjen e Publikut dhe të OJF-ve Mjedisore në Proçesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis" gjendet i botuar në sitin zyrtar të MMPAU.

Ndërkohë, në Fletore Zyrtare Ekstra, të nxjerra gjatë verës së vitit 2010, gjendet i botuar edhe një udhëzim tjetër i MMPAU, konkretisht: "Udhëzim i MMPAU nr.3, datë 19.11.2009 - Për metodologjinë e vlerësimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis (botuar ne FZ Ekstra nr. 68).

Kërkimi në dokumenta të tjerë qeveritarë, nuk sugjeroi ekzistencën e ndonjë udhëzimi të MMPAU me numër indeksues më të lartë se "3" për vitin 2009,

edhe pse një mundësi e tillë nuk përjashtohet as teorisht, as praktikisht.

Por, metodologjikisht, udhëzim i MMPAU nr.3, datë 19.11.2009, mbyll vargun indeksues, duke caktuar edhe nivelin mbi të cilin kryhen llogaritjet sa i takon botimit në Fletore Zyrtare.

Në tabelën e mëposhtme, jepet një paraqitje vizive e mungesave të konstatuara sa i takon botimit në fletore të udhëzimeve të nxjerra nga titullari i MMPAU:

1	2	3
---	---	---

Me të gjelbër në këtë rast është shënuar kutia që korrespondon me udhëzimin Nr. 3, të botuar në Fletore Zyrtare Ekstra 68.

Si konkluzion, ashtu sikurse sugjerojnë edhe kutizat e ngjyrosura,



në Fletore Zyrtare 2009, nuk janë botuar të paktën 2 udhëzime të MMPAU ose 66.6% e totalit





Udhëzime të Ministrisë së Bujqësisë (MBUMK)

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nxjerr një numër të vogël udhëzimesh brenda një viti, të cilat indeksohen gjithashtu nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do të thotë se seria e aktit hapet në fillim të çdo

viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr udhëzimi i fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor). Nga hulumtimi një për një i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2009, gjendet i botuar vetëm një udhëzim, konkretisht:



Udhëzimi Nr.2 Datë 31/03/2009 i MBUMK & MF “Mbi zbatimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërpartit të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit”

(botuar në Fletore Zyrtare Nr.84, Datë 11/06/2009, Fq 3690)

Pavarësisht se ky është një udhëzim i përbashkët i dy ministrive, ai është propozuar nga MBUMK, e cila e ka renditur në vargun e vet indeksues, njësoj sikurse vepron edhe MF kur është ajo që inicion udhëzime të përbashkëta. Ky në fakt është edhe një lloj rregulli i pashkruar që ndiqet nga një pjesë e ministrive të kabinetit qeveritar.

Nga shqyrtimi i burimeve zyrtare në internet, rezultoi se në datë 30.04.2009, ministri i Bujqësisë ka nxjerrë Udhëzimin nr 3 “Mbi rregullat shëndetësore të kafshëve në lidhje me prodhimin, përpunimin, shpërndarjen dhe importin e produkteve me origjinë shtazore për konsum njerëzor”.

Pra, gjatë vitit 2009, titullari i MBUMK ka nxjerrë të paktën 3 udhëzime, dy prej të cilave, konkretisht ai

me nr. 1 dhe nr.3, nuk janë botuar në Fletore Zyrtare. Kërkimi në dokumenta të tjerë qeveritarë, nuk hasi në ekzistencën e ndonjë udhëzimi tjetër të MBUMK që të këtë numër indeksues më të lartë se 3, edhe pse kjo nuk duhet përjashtuar teorikisht.

Në tabelën e mëposhtme, jepet një paraqitje vizive e mungesave të konstatuara sa i takon botimit në fletore të Udhëzimeve të nxjerra nga titullari i MBUMK

1	2	3
---	---	---

Portokalli: udhëzime që nuk janë botuar në FZ.
E verdhë: udhëzime të pabotuara, por të identifikuar.
(shih: Tabelën Nr.1).

Megjithë kufizimin metodologjik në këtë rast, si konkluzion mund të thuhet se:

në Fletore Zyrtare 2009, nuk janë botuar të paktën 2 udhëzime të MBUMK ose 66.6% e totalit



SHENIM METODOLOGJIK: Ministrinë që vijojnë më poshtë, përdorin një sistem të ndryshëm "indeksimi" për udhëzimet që nxjerrin. Në fakt, me tepër sesa indekse aktesh, ato mund të konsiderohen numra protokollit të cilat "pagëzojnë" udhëzimin. Nuk përjashtohet në ndonjë rast mundësia që, numri indeksues të jetë i prejardhur nga vitet pararendëse. Kjo e bën të pamundur vlerësimin e rregullsisë së vargut indeksues, element bazë mbi të cilin mbështetet metoda monitorues që përdor ÇIP.

Në pamundësi për të hulumtuar vargun indeksues me bazë kalendarike, nga ku do të mund të identifikoheshin edhe mungesat eventuale të botimit në Fletore Zyrtare, ÇIP do të kufizohet

vetëm në aplikimin e hallkës Faktike të verifikimit. E thënë ndryshe, përmes shqyrtimit të faqeve zyrtare, dokumentave qeveritare (raporte vjetore, strategji etj.) do të synohet identifikimi i atyre udhëzimeve që nuk figurojnë të botuara në Fletore Zyrtare.

Meqë faqet zyrtare në internet të këtyre ministrive nuk publikojnë udhëzime (me përjashtime të rralla), atëherë rezultatet e monitorimit për këto ministri do të konsiderohen "të brishta" nga pikëpamja metodologjike. Pavarësisht kësaj, gjetjet për udhëzimet e lëna jashtë botimit në Fletore Zyrtare për këto ministri, nuk mund të jenë në asnjë rast më të vogla se ato që do të reklamohen më poshtë; përkundrazi, ato në çdo rast janë teorikisht më të mëdha.



Udhëzime të Ministrisë së Drejtësisë (MD)

Nga hulumtimi një për një i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2009, rezultojnë të botuara 3 udhëzime të Ministrisë së Drejtësisë. Dy prej tyre janë udhëzime të përbashkëta me Ministrinë e Financave,

ku kjo e fundit ka kundërsiguar. Nga kërkimi në burimet alternative zyrtare ku arkivohen akte, nuk u gjend ndonjë udhëzim tjetër i kësaj ministrie, që të rezultojë i lënë jashtë botimi në Fletore Zyrtare, 2009.

Si konkluzion, edhe pse në kushtet e kufizimit metodologjik, mund të pohohet se:

nuk u identifikuan udhëzime të MD të lëna jashtë botimi në Fletore Zyrtare, 2009



Udhëzime të Ministrisë së Punës (MPÇSSHB)

Pas shfletimit të të gjitha Fletoreve Zyrtare 2009, rezultojnë të botuara 7 udhëzime të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, MPCSSHB.

Nga kërkimi në burimet alternative zyrtare ku arkivohen akte (websiti zyrtar i MPÇSSHB, raporte vjetore, strategji etj.), nuk u gjend ndonjë udhëzim tjetër i lënë jashtë botimit në Fletore Zyrtare 2009.

Si konkluzion, mund të pohohet se:

nuk u identifikuan udhëzime të MPÇSSHB të lëna jashtë botimi në Fletore Zyrtare, 2009



Udhëzime të Ministrisë së Ekonomisë (METE)

Nga hulumtimi i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2009, rezultuan të botuara 6 udhëzime të Ministrisë së Ekonomisë, Transportit dhe Energjitikës.

e dokumentacionit për pajisje me leje minerare", i cili rezultoi i botuar në Fletore Zyrtare 202 e cila rezultoi të ketë dalë nga botimi në 5.4.2010. Lidhur me këtë udhëzim dhe efektet që ai prodhonte, ka pasur edhe një shqetësim mediatik.

Ndërkohë, Nr. 1028, datë 10.12.2009, "Për përmbajtjen

Si konkluzion, mund të pohohet se:

nuk u identifikuan udhëzime të METE të lëna jashtë botimi në Fletore Zyrtare, 2009





Udhëzime të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH)


Pas shfletimit të të gjitha Fletoreve Zyrtare 2009, nuk u gjend i botuar asnjë udhëzim i Ministrisë së Shëndetësisë. Për më tepër, nuk rezultojnë udhëzime të nxjerra nga titullari i kësaj ministrie të jenë të botuara në Fletoret Zyrtare Ekstra që QPZ ka nxjerrë gjatë verës së vitit 2010.

Në rastin e MSH, rendi indeksues nuk është madje as "protokollar". Në burimet zyrtare alternative të shfletuara në kuadër të këtij monitorimi, janë gjetur 3 udhëzime të MSH të nxjerra gjatë 2009-ës. Dy prej tyre janë ato me nr. 558 dhe nr. 731. Ky i fundit, në dispozitën e tij nr. 15, përcakton shprehimisht se: "Udhëzimi nr. 83, datë 09.02.2009 shfuqizohet". Kjo do të thotë se, përveç dy udhëzimeve të treguara më sipër (shiko

faksimilet), ekziston edhe një i tretë me nr. 83.

Ndërkohë, në 29 prill 2009, shtypi i përditshëm, në kuadër të raportimeve për epideminë e gripit të derrit, flet për një udhëzim të MSH me titull: "Për shërbimin mjekësor në pikat kufitare të kontrollit". Nuk rezultojnë më shumë të dhëna lidhur me këtë udhëzim nga ndonjë burim tjetër zyrtar. Edhe pse nuk ka arsye të mendohet se një udhëzim i tillë nuk ekziston, për arsye metodologjike, ai nuk do të përlllogaritet si i pabotuar, pasi shtypi i përditshëm, nuk konsiderohet burim zyrtar informacioni në kuadër të këtij monitorimi. Si konkluzion mund të thuhet se:

u identifikuan të paktën 3 udhëzime të MSH të pabotuara në Fletore Zyrtare 2009



Faksimile të 2 udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë



TABELA NR.1

Nr.	Udhëzime të identifikuar konkretisht (si titull dhe/ose si përmbajtje) të cilat nuk gjenden të botuara në Fletore Zyrtare, 2009	Nr. i udhëzimit	Emri i ministrisë	Data e udhëzimit
1	PER ZBATIMIN E BUXHETIT PER VITIN 2009	2	MF	9/1/2009
2	PER PERGATITJEN E BUXHETIT TE SHTETIT DHE FONDET SPECIALE"	20	MF	26/2/2009
3	PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT VENDOR	20/1	MF	26/2/2009
4	PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT VENDOR	20/3	MF	10/7/2009
5	PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE MËNYRËS SË PAGESËS SË KOMPENSIMIT TË ÇMIMIT TË LETËRNJOFTIMIT PËR SHTRESAT NË NEVOJË	27/1	MF	15/5/2009
6	PER RREGULLAT E HOLLESISHME DHE MENYREN E PAGESES SE KONPESIMIT TE POSTES SHQIP-TARE Sh.A. PER CMIMIN E LETERNJOFTIMIT	29	MF	4/5/2009
7	TARIFAT E SHPERBLIMIT TE PERSONAVE QE AKTIVIZOHEN NE PROCESIN E KUALIFIKIMIT TE AUDITUESVE TE BRENSHEM NE SEKTORIN PUBLIK	39	MF	24/9/2009
8	MBI KRIJIMIN DHE PERDORIMIN E FONDIT TE VECANTE NGA NJESITE E QEVERISJES SE PERGJITHSHME	50	MF	9/12/2009
9	PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, MASËS DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITUESIT NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKENCËTARËT E RINJ...	2	MASH	22/1/2009
10	PËR DETAJIMIN E BUXHETIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT LARTË	3	MASH	22/1/2009
11	PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E DIPLOMËS SË LËSHUAR NGA INS T. E ARSIMIT TË LARTË	5	MASH	18/2/2009
12	PËR SUPLEMENTIN E DIPLOMËS	7	MASH	18/2/2009
13	KRITERET E EKUIVALENTIMIT DHE REGJISTRIMIN NË MATUREN SHTETËRORE 2009 TË SHQIP-TARËVE QË KANË KRYER SHKOLLËN E MESME JASHTË SHTETIT	11	MASH	9/3/2009
14	PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE ÇERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËSHILLAT SHKENCORË	12	MASH	18/2/2009
15	PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT, TARIFËN E REGJISTRIMIT PËR KONKURRIM, NË DISA PROGRAME STUDIMI NË CIKLIN E PARË ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009 - 2010	18	MASH	7/7/2009
16	PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË TRAJTIMIT TË PUNONJËSVE TË ARS. PARAUNIVERSITAR.		MASH	22/8/2009
17	PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTIT. PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR ...	25	MASH	9/9/2009
18	PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARIVE NË SHËRBIM TË NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR	34	MASH	22/8/2009
19	PER PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE MASTER I NIVELIT TË DYTË, NË INSTIT. PUBLIKE TE ARSIMIT TE LARTË	35	MASH	4/11/2009
20	REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE DHE PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA NË FAZËN E KATËRT PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTIT. PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, VITI AKADEMIK 2009 - 2010		MASH	23/11/2009
21	PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009- 2010		MASH	23/11/2009
22	PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2009-2010 ME KOHË TË PJESHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET	38	MASH	25/11/2009
23	PËR PROÇEDURAT E NJOHJES SË DIPLOMAVE DHE ÇERT. NË SHKOLLAT E LARTA TË HUAJA	41	MASH	8/12/2009
24	ZBATIMIN E RREGULLAVE NË ORGANIZIMIN E KOHËS SË PUNËS TË PERSONAVE QË KRYEJNË TRANSPORT TË LËVIZSHËM, TË ORTAVE TË PUNËS SË DREJTUESVE TË MJETEVE ZBATIMIN E RREGULLAVE PËR KONTROLLIN...	5	MPPTT	6/5/2009
25	PËR DETYRAT E ORGANEVE MJEDISORE PËR TË SIGURUAR PJESËMARRJEN E PUBLIKUT DHE TË OJF-VE MJEDISORE NË PROÇESIN E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS"	1	MMPAU	3/3/2009
26	PËR METODOLOGJINË E VLERËSIMIT TË RAPORTIT TË VLERËSIMIT TE NDIKIMIT NË MJEDIS **	3	MMPAU	19/11/2009
27	MBI RREGULLAT SHENDETESORE TE KAFSHEVE NE LIDHJE ME PRODHIMIN, PËRPUNIMIN, SHPËRNDARJEN DHE IMPORTIN E PRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE PER.....	3	MBUMK	30/4/2009
28	PER REGJISTRIMIN DHE LEVIZJEN E PACIENTIT BRENDA INSTITUCIONEVE SHENDETESORE NE ZBATIM TE SISTEMIT TE REFERIMIT	558	MSH	26/10/2009
29	MBI MENYREN E ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TE PROCEDURAVE TE PERQENDRUARA TE PROKURIMIT PUBLIK NE SHERBIMIN SPITALOR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE	731	MSH	28/12/2009
30	(nuk disponohet titulli, por vetem nr. dhe dt. e udhëzimit)	83	MSH	9/2/2009



Në Tabelën Nr.2, përveç rezultateve të përmbledhura të 2009-ës, jepen përmbledhtazi edhe rezultatet e verifikimit për botimin e udhëzimeve në Fletore Zyrtare gjatë viteve 2006-2007-2008. Për këto tre vite, për ekonomi kohe dhe vendi, nuk do të reklamohen udhëzime konkrete të identifikuar (titull dhe/ose përmbajtje) si të pabotuara, por vetëm totali i botuar në FZ dhe ai i pabotuar. Po ashtu, është përlogaritur në % totali i udhëzimeve të pabotuar në FZ për secilën prej katër ministrive që nga 2006-ta

deri në 2009-ën. Në tabela janë grupuar vetëm udhëzime të atyre ministrive të cilat përdorin sistem të rregullt indeksimi këte lloj akti (varg numerik rritës). Këto të dhëna për llojin e aktit: udhëzim, synojnë të plotësojnë gjetjet e monitorimit të vjetshëm të ndërmarrë nga Qendra ÇIP, mbështetur nga OSFA (Fondacioni Soros), objekt i të cilit ishin vetëm ligjet e Kuvendit, VKM-të, dhe aktet normative me fuqinë e ligjit të KM gjatë tre-vjeçarit 2006-2007-2008.

VITI 2009		TABELA NR.2		
Emri i institucionit	Udhëzime të nxjerra	Udhëzime të botuara	Udhëzime të pabotuara	Udhëzime të pabotuara në %
KËSHILLI I MINISTRAVE	2	2	0	0 %
MINISTRIA E FINANCAVE	56 (4 me fraksione)	33	23	41%
MINISTRIA E ARSIMIT	41	3	38	93%
MINISTRIA E PPTT	11	6	5	45%
MINISTRIA E BUJQËSISË	3	1	2	66%
MINISTRIA E MJEDISIT	3	1	2	66%
VITI 2008				
KËSHILLI I MINISTRAVE	3	3	0	0%
MINISTRIA E FINANCAVE	48 (7 me fraksione)	39	9	18%
MINISTRIA E ARSIMIT	45	22	23	51%
MINISTRIA E PPTT	24 (1 me fraksion)	11	13	54%
MINISTRIA E BUJQËSISË	6 (1 me fraksion)	2	4	66%
MINISTRIA E MJEDISIT ¹	5	4	1	2%
VITI 2007				
KËSHILLI I MINISTRAVE	6	6	0	0%
MINISTRIA E FINANCAVE	30 (1 me fraksion)	24	6	20%
MINISTRIA E ARSIMIT	41	5	36	88%
MINISTRIA E PPTT	20	12	8	40%
MINISTRIA E BUJQËSISË	12 (1 me fraksion)	3	9	75%
MINISTRIA E MJEDISIT ²	10	5	5	50%
VITI 2006				
KËSHILLI I MINISTRAVE	5	5	0	0%
MINISTRIA E FINANCAVE	12	12	0	0%
MINISTRIA E ARSIMIT	49	3	46	93%
MINISTRIA E PPTT	7	4	3	42%
MINISTRIA E BUJQËSISË ³	2	2	0	0%
MINISTRIA E MJEDISIT ⁴	7	5	2	28%

1 - MMPAU ka nxjerrë dy udhëzime që mbajnë të njëjtin indeks: Udhëzim Nr 4 Datë 10-04-2008 dhe Udhëzim Nr 4 Datë 12-09-2008

2 - MMPAU ka nxjerrë dy udhëzime që mbajnë të njëjtin indeks: Udhëzim Nr.5 Date 24/09/2007 dhe Udhëzim Nr 5 Datë 28-12-2007

3 - MBUMK ka nxjerrë dy udhëzime që mbajnë të njëjtin indeks: Udhëzim Nr 1 Datë 20-02-2006 dhe Udhëzim Nr 1 Datë 09-11-2006

4 - MMPAU ka nxjerrë dy udhëzime që mbajnë të njëjtin indeks: Udhëzim Nr 3 Datë 17-05-2006 dhe Udhëzim Nr 3 Datë 13-09-2006

4

PUSHTETI GJYQESOR

Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (neni 7 i Kushtetutës).

Pushteti gjyqësor garanton mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e normave kryesore të vendosura, me qëllim që të realizojë zhvillimin e një jete të rregullt sociale. Në Republikën e Shqipërisë, Pushteti Gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga Gjykatat e Apelit si dhe ato të Shkallës së Parë (neni 135 i Kushtetutës).

Ligji organik nr 8436, dt 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” rregullon në tërësi organizimin e drejtësisë bazuar në Kushtetutën e vendit, kurse aktiviteti i Gjykatës së Lartë rregullohet me ligj organik të veçantë, konkretisht, ligji nr.8588 dt.15/03/2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh.”

Një nga funksionet më të rëndësishme të Gjykatës së Lartë është edhe unifikimi i praktikës gjyqësore në Republikën e Shqipërisë. Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, ajo tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore. Vendimet e Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme për t’u ekzekutuar.

Ligji nr.8588 dt.15/03/2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh.”, i ka kushuar një rëndësi të veçantë shpalljes dhe botimit të vendimeve të kësaj gjykate. Neni 19 i ligjit në fjalë, përcakton shprehimisht se:

1. Vendimet e Gjykatës së Lartë shpallen të arsyetuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor.
2. Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, botohen në Buletinin Periodik të Gjykatës së Lartë.
3. Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Ligjvënësi ka përcaktuar qartë dhe prerë në pikën 3 të nenit 19 detyrimin për botimin në Fletoren Zyrtare më të parë të vendimeve për njësimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore (vendimet unifikuese të GJL).

Ky nen përmban një detyrim të dyfishtë: përveçse duhet botuar në Fletore Zyrtare, kjo duhet bërë edhe në kohën më të shpejtë të mundshme (në numrin më të parë të Fletores Zyrtare). Respektimi i modaliteteve të publikimit të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë garanton interpretimin dhe zbatimin uniform të ligjeve, në respekt të parimit të sigurisë ligjore.

Përmes vendimeve që japin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sigurohet uniformitet në interpretimin e ligjeve në procesin gjyqësor prej të gjithë trupës së gjyqtarëve (rreth 350). Mosbotimi i tyre në Fletore Zyrtare do të shkaktonte *apriori* mos-përm-bushjen e qëllimit të synuar për unifikim të praktikës gjyqësore.

Nga ana tjetër, arsyeja se përse ligjvënësi ka përcaktuar që këto lloj vendimesh duhet të botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare, ka të bëjë me faktin se ato duhet të njihen sa më shpejt që të jetë e mundur nga trupa gjyqësore e gjykatave më të ulta, me qëllim që praktika, tashmë e unifikuar përmes interpretimit ligjor të Gjykatës së Lartë, të reflektohet në kohën e duhur në çështjet relevante në shqyrtim apo që do të shqyrtohen prej tyre.

Bazuar në parashtrimet e mësipërme, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, në kuadër të këtij monitorimi do të vlerësohen si në *terma të botimit*, ashtu edhe në *terma kohorë* të botimit të tyre në Fletore Zyrtare. Ekipi monitorues ka evidentuar në kolonë të posaçme në Tabelën Nr. 3 dhe Nr.5, Fletoren Zyrtare ku gjendet i botuar vendimi unifikues i GJL si dhe ka përllogatur në mënyrë të përafërt se cila do të duhej të kishte qenë Fletorja Zyrtare “më e afërt” në të cilën do të duhej të botohej vendimi unifikues i GJL.





Rezultatet e monitorimit, 2009

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë



Botimi në Fletore Zyrtare

Gjatë vitit 2009, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë dhënë 18 vendime gjithsej; 11 për çështje civile dhe 7 për çështje penale. (burimi: web-siti zyrtar i GJL). Nga ky total, 8 janë vendime unifikuese të cilat, sipas nenit 19, pika 3 e ligjit 8588, "Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të

R.Sh.", botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Nga shqyrtimi një për një i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2009, rezultoi se janë botuar gjithsej 8 vendime unifikuese të dhëna nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Si konkluzion:

gjatë vitit 2009, janë botuar në Fletore Zyrtare të gjitha vendimet unifikuese të GJL



Afatet e botimit në Fletore Zyrtare

Gjatë vitit 2009, të gjitha vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë (8 gjithsej) janë botuar në Fletore Zyrtare me mjaft vonesë nga afati ligjor i parashikuar. Vonesa më e madhe konstatohet në rastin e vendimit unifikues civil Nr.1 Dt. 6.1.2009 (Nr.6/4 i Regj. Themeltar), i cili është botuar në Fletore Zyrtare plot 11 muaj nga data e shpalljes (FZ nr.171, dt. 09/12/2009).

Mesatarja e vonesës së botimit në Fletore Zyrtare 2009 të të 8-ta vendimeve është rreth 4.2 muaj (shiko: Tabela Nr.5).

Ritheksojmë edhe njëherë se neni 19, pika 3, ligji 8588, përcakton se: "Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare".

Nëse ky detyrim ligjor do të ishte respektuar nga ana e Gjykatës së Lartë, vendimi në fjalë do të duhej të botohej në FZ nr 8, dt 9/2/2009, e cila, sipas një llogaritjeje të përafërt, që fillon 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor, rezulton të ketë qenë "numri më i parë i Fletores Zyrtare".

Duke përlogaritur afatin ligjor 30 ditor që ka në dispozicion GJL të shpallë vendimin e arsyetuar, rezulton se:

mesatarja e vonesës së botimit në Fletore Zyrtare 2009 të të 8-ta vendimeve unifikuese të GJL është rreth 4.2 muaj





Rasti "Deliu"

Përveçse një shkelje e drejtpërdrejtë e dispozitave të ligjit nr. 8588, vonesat në shpalljen dhe botimin e vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, mund të prodhojnë indirekt shkelje të dispozitave kushtetuese prej vetë kësaj të fundit, madje me pasoja jashtëzakonisht të rrezikshme për individin, duke filluar që nga privimi arbitrar i lirisë e deri te siguria për jetën.

Në një rast të tillë, Gjykata e Lartë, si organi më i lartë i pushtetit gjyqësor, në vend që të përmbushë misionin e saj për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e normave kryesore të vendosura nga ligjvënësi, do të ishte duke bërë ekzaktësisht të kundërtën.

Rasti më flagrant i konstatuar në 2009-ën është ai i ish të dënuar P. Deliu, i cili u mbajt padrejtësisht në burg 5 muaj më shumë për shkak të mos-shpalljes dhe mos-botimit në afatin e përcaktuar ligjor të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë. Ky vendim, (Nr.6/5 i Regj. Themeltar, Nr.2 i Vendimit), i dhënë që në datë 06.02.2009, u botua në Fletore Zyrtare nr 125, në dt. 24.08.2009.


Në fakt, sipas një përllogaritjeje të përafërt, ai duhej të ishte botuar 5 muaj më parë, në Fletore Zyrtare nr. Nr.21, dt. 6/3/2009, e cila do të korrespondonte në këtë rast me "numrin më të parë të Fletores Zyrtare", pas 30 ditësh që është afati ligjor në dispozicion të GJL për të shpallur vendimin.

Duke qëndruar në burg padrejtësisht për 5 muaj të tjerë, shtetasit P. Deliu iu privua arbitrarisht liria nga vetë Gjykata e Lartë e cila nuk respektoi afatet ligjore të shpalljes së vendimit (neni 19, pika 1, e ligjit nr.8588 dt.15/03/2000 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh.)

Shkelja e këtyre afateve, prodhoi si pasojë të drejtpërdrejtë dhunimin e nenit 27/1 të Kushtetutës së Shqipërisë, sipas të cilit: "Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj". Shkaktari që prodhoi këto pasoja në këtë rast është ironikisht vetë Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë.

Në datë 30/07/2009, Avokati i Popullit, i cili mori dijeni mbi rastin në fjalë, iu drejtua zyrtarisht Kryetares së Gjykatës së Lartë, Znj.Shpresa BEÇAJ, për dijëni edhe Prokurores së Përgjithshme, Znj. Ina RAMA, me anë të një shkresë me nr. Prot. K2/P15-8. Ai konstatonte shkeljen e nenit 19, pika 1 të ligjit 8588 datë 15.03.2000.

Po ashtu, rezulton të jetë shkelur rrjedhimisht edhe pika 3 e nenit 19 e të njëjtit ligj, sipas të cilës: "Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare". Në letrën e tij, Avokati i Popullit theksonte se: "Ky është rast i përsëritur, sepse para disa muajsh ka ndodhur e njëjta praktikë edhe për të dënuar Xhavit Hoxha për të cilin është dërguar gjithashtu rekomandim më dt. 02.06.2009" me shkresë nr.K2/R2-7."



REPUBLIKA E SHQIPERISE AVOKATI I POPULLIT

Nr. K2/P15-8 Prot. Tiranë, më 30/07/2009
Nr. Dok. 200901422/8

Lenda: Rekomandohet marrja e masave për elizimin e vendimeve penale ndaj personave që duhet të lirohen nga burgu, menjëherë pas shpalljes së vendimeve nga Gjykata e Lartë.

Drejtuar: Kryetares së Gjykatës së Lartë
Zj. Shpresa BEÇAJ

Prokurores së Përgjithshme
Zj. Ina RAMA

TIRANE

Mbi bazën e medias së shkruar dhe kokretisht artikullit të gazetës "Metropoli" të datës 01.07.2009, "I liruar me vendim pesë muaj peng nga gjykata e okuzat". Institucioni i Avokatit të Popullit me inisiativën e tij ka marrë për shqyrtim dhe ndjekje rrethin e të dënuar Petrit Deliu nga Ofshku i Beratit.

Nga ana e juaj është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë si dhe është administruar pranë sekretariatit gjyqësor një kopje e vendimit Nr.2 datë 06.02.2009 e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nëpërmjet drejtorit të I.E.V.P. Kosovë e Lushnjës kemi marrë dhe shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme sëbashku me urdhrin për cëkzim të vendimit penal që rrihet datën 08.07.2009 dhe që në atë institucion ka shkruar më datën 09.07.2009.

Nga verifikimet e kryera dhe studimi i akteve shkresore ka rezultuar se: Më datën 06.02.2009 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendim Nr. 2 kanë vendosur ndërmjet të jenerve:

"Deklarimin fajtor të pandehurit Petrit Deliu për veprën penale të "Rrëmbit ose mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese" në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burg.

Deklarimin fajtor të pandehurit Petrit Deliu, për veprën penale të "Vjedhjes" në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burg.

Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Leonard Zeka (duhet të jetë Petrit Deliu) me 3 (tre) vjet burg, duke i filluar vrasitja e dënimin nga dita e ndalimit datë 26.10.2000".

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për t'u botuar në Fletoren Zyrtare. Në përputhje me datën 07.07.2009 dërguar me shkresën Nr.T207 Prot, Gjykata e

Faksimile e
Rekomandimit
të Avokatit
të Popullit



PNr.6/5 i Regj. Themeltar
Nr.2 i Vendimit

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**


Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Perikli Zaharia	Anetar
Irma Bala	Anetare
Evjani Sinoimeri	Anetare
Spiro Spiro	Anetar
Besnik Imeraj	Anetar
Gani Dizdari	Anetar
Ardian Dvorani	Anetar
Fatos Lulo	Anetar
Arjana Fullani	Anetare
Evelina Qirjako	Anetare
Majlinda Andrea	Anetare
Ardian Nuni	Anetar
Guxim Zenelaj	Anetar
Aleksander Muskaj	Anetar
Andi Çeliku	Anetar

në seancën gjyqësore të datës 06.02.2009 moren në

TË PANDEHURVE: NP

Faksimile të VU të GJL
dhe faksimile e FZ,
ku është botuar VU



Lënien në fuqi të vendimit nr.108, datë 24.03.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë për të gjykuarin Nderim Deliu.
Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për t'u botuar në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 06.02.2009

Tabela Nr. 3 - Afatet e botimit në Fletore Zyrtare të VUGJL, 2009

Nr.	Numri indeksues i Vendimit Unifikues (VU)	Data e Vendimit Unifikues	Fletorja Zyrtare ku është botuar VU	Fletorja Zyrtare ku duhej botuar VU
1	Nr.6/4 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	6.1.2009	Nr.171 Dt. 9/12/2009	Nr.8 Dt. 9/2/2009
2	Nr.5/3 i Regj.Themeltar Nr.2 i Vendimit	6.1.2009	Nr.82 Dt. 8/6/2009	Nr.8 Dt. 9/2/2009
3	Nr.7/5 i Regj. Themeltar Nr.5 i Vendimit	20.1.2009	Nr.102 Dt. 8/7/2009	Nr.13 Dt. 20/02/09
4	Nr.4/3 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	8.1.2009	Nr.117 Dt. 10/8/2009	Nr.8 Dt. 9/2/2009
5	Nr.6/5 i Regj. Themeltar Nr.2 i Vendimit	6.2.2009	Nr.125 Dt. 24/08/09	Nr.21 Dt. 6/3/2009
6	Nr.9 i Regj. Themeltar Nr.4 i Vendimit	24.6.2009	N.125 Dt. 24/08/09	Nr.112 Dt. 24/07/09
7	Nr.2/1 i Regj. Themeltar Nr.5 i Vendimit	15.9.2009	Nr.171 Dt. 9/12/2009	Nr.145 Dt. 20/10/09
8	Nr.6/5 i Regj. Themeltar Nr.2/1 i Vendimit	2/10/2009	Nr.162 Dt. 27/11/09	Nr.148 Dt. 2/11/2009





Rezultatet e monitorimit 2006-2007-2008

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë

Në vitin 2008, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë dhënë 4 vendime gjithsej; 3 prej tyre janë vendime për çështje civile dhe 1 është për çështje penale (burimi: www.gjykataelarte.gov.al). Nga këto, 2 janë VU, të cilat, sipas neni 19, pika 3 e ligjit 8588, "botohen në numrin më të parë të Fletore Zyrtares". Nga shqyrtimi një për një i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2008, rezultuan të botuara 2 vendime unifikuese të dhëna nga Kolegjet e Bashkuara të GJL (Tab. Nr.4). Kjo çon në konkluzionin se:

gjatë vitit 2008, janë botuar në Fletore Zyrtare të gjitha vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë

Në vitin 2007, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë dhënë 27 vendime gjithsej; 25 prej tyre janë vendime për çështje civile dhe 2 janë për çështje penale (burimi: www.gjykataelarte.gov.al). Nga këto 27 vendime, 9 janë vendime unifikuese. Në Fletore Zyrtare 2007, rezultojnë të botuara gjithsej 8 vendime unifikuese të dhëna nga Kolegjet e Bashkuara të GJL (Tab. Nr.4), çka do të thotë se:

gjatë vitit 2007, nuk është botuar në Fletore Zyrtare një vendim unifikues i GJL



Edhe pse i pabotuar në Fletore Zyrtare, ky vendim unifikues gjendet në faqen zyrtare në internet të Gjykatës së Lartë. Ai është Vendimi i GJL nr.12, dt. 14.09.2007, çështja: "Seri Yska, Nexhmije Yska, Xhaferr Alimadhi, Athina Alimadhi, Hysen Baliqi, Klarita Baliqi kundër Byroja Shqiptare e Sigurimeve në mungesë...". Në pikën 2 të këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë përcaktojnë shprehimisht: "Ky vendim është unifikues për praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare".

Në vitin 2006, Kolegjet e Bashkuara të GJL kanë dhënë 14 vendime gjithsej; 13 prej tyre janë vendime për çështje civile dhe 1 është për çështje penale (burimi: www.gjykataelarte.gov.al). Nga këto 14 vendime, 6 janë unifikuese. Në Fletore Zyrtare 2006, rezultojnë të botuar gjithsej 6 vendime unifikuese (Tab. Nr.4), që do të thotë se:

gjatë vitit 2006, janë botuar në Fletore Zyrtare të gjitha vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë

SHENIM: Përsa i takon afateve ligjore të botimit të VUGJL për vitet 2006-2007-2008, në Tabelën Nr.4 dhe Nr. 5 ofrohet një paraqitje e detajuar e situatës së konstatuar.



Tabela Nr. 4 - Afatet e botimit në Fletore Zyrtare të VUGJL, 2006-2007-2008

Viti	Nr.	Numri indeksues i Vendimit Unifikues (VU)	Data e Vendimit Unifikues	Fletorja Zyrtare ku është botuar VU	Fletorja Zyrtare ku duhej botuar VU
2008	1	Nr.8 i Regj. Themeltar Nr.3 i Vendimit	12/2/2008	Nr.150 3/10/2008	Nr.37 12/3/2008
	2	Nr.1iRegj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	27/03/2008	Nr.149 24/09/08	Nr.59 25/04/08
2007	1	Nr.2/2 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	25/01/07	Nr.97 1/8/2007	Nr.18 24/02/07
	2	Nr.8/1i Regj. Themeltar Nr.3 i Vendimit	24/01/07	Nr.18 24/02/07	Nr.18 24/02/07
	3	Nr.10/3 i Regj. Themeltar Nr.5 i Vendimit	22/01/07	Nr.30 23/03/07	Nr.15 22/02/07
	4	Nr.9/2 i Regj. Themeltar Nr.6 i Vendimit	24/01/07	Nr.97 1/8/2007	Nr.18 24/02/07
	5	Nr.1 Regj Themeltar Nr.8 i Vendimit	12/9/2007	Nr.150 13/11/07	Nr.133 11/10/2007
	6	Nr.4 i Regj. Themeltar Nr.10 i Vendimit	12/9/2007	Nr.156 27/11/07	Nr.133 11/10/2007
	7	Nr.12/5 i Regj. Themeltar Nr.19 i Vendimit	15/11/07	Nr.191 7/2/2008	Nr.168 17/12/07
	8	Nr.5 i Regj. Themeltar Nr.20 i Vendimit	15/11/07	Nr.191 7/2/2008	Nr.168 17/12/07
2006	1	Nr.11/2 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	31/01/2006	Nr.43 Dt 10/05/06	Nr.13 Dt.01/03/06
	2	Nr.13/4 i Regj. Themeltar Nr.3 i Vendimit	3/2/2006	Nr.43 Dt 10/05/06	Nr.16 Dt.06/03/06
	3	Nr.12 i Regj. Themeltar Nr.4 i Vendimit	1/2/2006	Nr.34 Dt.14/04/06	Nr.13 Dt.01/03/06
	4	Nr.5 i Regj. Themeltar Nr.5 i Vendimit	3/3/2006	Nr.54 Dt 02/06/06	Nr.22 Dt.06/04/06
	5	Nr.7 i Regj. Themeltar Nr.9 i Vendimit	9/3/2006	Nr.119 Dt. 20/11/06	Nr.26 Dt. 10/04/06
	6	Nr.7 i Regj. Themeltar Nr.13 i Vendimi	9/3/2006	Nr.107 Dt.13/10/06	Nr.26 Dt.10/04/06

Tabela Nr. 5 - Përlllogaritja në % e mesatares së vonesës së botimit në FZ të VUGJL

Viti	Vendime të Kolegjeve të Bashkuara, Gj.L.	(VU)	VU Civile	VU Penale	VU të pabotuara në FZ	Vonesa mesatare e botimit në F.Z.
2009	18	8	3	5	0	4.2 muaj
2008	4	2	1	1	0	6.1 muaj
2007	27	9	1	8	1	2.3 muaj
2006	14	6	6	0	0	3.3 muaj



5

GJYKATA KUSHTETUESE

Edhe pse në kuadër të këtij studimi, botimi i akteve të Gjykatës Kushtetuese trajtohet pas kapitullit për Gjyqësorin, vetë kjo gjykatë nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor të zakonshëm. Ajo ka një juridiksion të veçantë për kontrollin e kushtetueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjerë normativë. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj (neni 124/1 i Kushtetutës). Gjatë ushtrimit të funksionit të saj ajo i nënshtrohet vetëm Kushtetutës (neni 124/2 i Kushtetutës). Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese janë të parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës, sipas të cilit ky organ vendos për:

- papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122 të Kushtetutës;
- papajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;
- papajtueshmërinë e akteve normativë të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;
- mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;
- kushtetutshmërinë e partive dhe organizatave të tjera politike si dhe të veprimtarisë së tyre në bazë të nenit 9 të Kushtetutës;
- shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;
- çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës dhe të deputetëve si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre;
- kushtetueshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;
- gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese rregullohet nga ligji organik nr. 8577, datë 10.2.2000. Sipas përcaktimit të nenit 2 të këtij ligji: "Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj".

Duke qenë legjislator negativ *sui generis*¹, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë rëndësi të veçantë. Ligji nr. 8577 i ka kushtuar një vëmendje të posaçme publikimit të këtyre vendimeve. Neni 26 i ligjit në fjalë përcakton se:

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare. Ato botohen në Fletoren Zyrtare dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit të saj. Kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij.
2. Organi që boton Fletoren Zyrtare detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi.
3. Gjykata Kushtetuese çdo vit përgatit një përmbledhje të vendimeve të saj.

Përsa i takon afateve kohore të botimit të VGJK në Fletore Zyrtare, ligji organik nr. 8577, datë 10.2.2000. nuk vendos afat për vetë GJK se kur duhet ta dërgojë vendimin për botim në QPZ, por, nga ana tjetër cakton afat për këtë të fundit se kur duhet të realizojë botimin e VGJK, shprehimisht: "jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi (QPZ)."

Ndërkohë, ligji nr. 8502, datë 30.6.1999 "Për krijimin e QPZ", i ndryshuar, përcakton shprehimisht se: "Organi përgjegjës, sipas ligjit, është i detyruar të paraqesë për botim në QPZ aktet e parashikuara në shkronjën "a" të nenit 2 të këtij ligji, brenda 3 ditëve nga miratimi i tyre dhe, në raste të veçanta, jo më vonë se 15 ditë." (Neni 6, ndryshuar me ligj nr.9091/2003).

Kjo do të thotë se, afati i lejuar ligjor, brenda të cilit duhet realizuar botimi në Fletore Zyrtare i VGJK është jo më shumë se 30 ditë, me përjashtim të rasteve kur GJK vendos vetë, që ai të hyjë në fuqi që me shpalljen e tij.

1 - "E Drejta Kushtetuese" Luan Omari; Aurela Anastasi, ribotim 2010, fq. 418





Rezultatet e monitorimit

Vendime të Gjykatës Kushtetuese



Botimi në Fletore Zyrtare

Gjatë vitit 2009, Gjykata Kushtetuese ka dhënë 32 vendime gjithsej (burimi: websiti zyrtar i GJK).

Në Fletoren Zyrtare 2009 rezultojnë të jenë botuar gjithsej 32 vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Nga verifikimi rezultoi se:

gjatë vitit 2009, janë botuar në Fletore Zyrtare të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese



Afatet e botimit në Fletore Zyrtare

Gjatë vitit 2009, nga 32 vendime të GJK gjithsej, vetëm 1 rezulton të jetë botua me vonesë në Fletore Zyrtare. Ky është vendimi nr 2, dt. 29.1.2009 "Për shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën të vendimit nr.1583, datë 03.12.2008 të Këshillit të Ministrave".

Ky vendim i GJK gjendet i botuar në Fletore Zyrtare Nr.59, dt. 14/05/2009. Fletorja zyrtare ku duhej të ishte botuar vendimi në fjalë, (duke llogaritur afatin maksimal prej 30 ditësh, do të duhej të ishte pikërisht ajo nr 19, e cila mban datën 27/2/2009

Si përfundim, mund të thuhet se:

gjatë vitit 2009, u botua me vonesë në Fletore Zyrtare (përtej afatit ligjor) vetëm 1 vendim i GJK



Rezultatet e monitorimit, 2006-2007-2008

Gjatë vitit 2008, Gjykata Kushtetuese ka dhënë 29 vendime gjithsej (burimi: websiti zyrtar i GJK). Gjatë vitit 2007 janë dhënë 45 vendime gjithsej, kurse në 2006-

ën janë dhënë 30 vendime nga GJK. Sa i takon afateve ligjore të botimit të vendimeve në Fletore Zyrtare, nuk u identifikuan raste vonesash gjatë këtyre tre viteve.

Nga verifikimi rezultoi se:

gjatë viteve '06-'07-'08, janë botuar në Fletore Zyrtare, brenda afatit, të gjitha vendimet e GJK



6

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg

Shqipëria është vend anëtar i Këshillit të Europës. Shteti shqiptar ka nënshkruar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në 13/07/1995 dhe e ka ratifikuar atë në 2/10/1996, duke e bërë pjesë të sistemit të brendshëm ligjor (neni 17/2 e Kushtetutës).

Sipas përcaktimit të nenit 1 të KEDNJ, Shtetet Palë të saj (pra edhe Shqipëria), marrin përsipër detyrimin që të respektojnë, ndaj cilitdo që ndodhet nën juridiksionin tyre, të drejtat dhe liritë themelore të sanksionuara në Konventë (dhe në protokollin shtesë të saj).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komiteti i Ministrave të KiE kontrollojnë përmbushjen nga Shtetet Palë, të detyrimeve të marra përsipër me ratifikimin e Konventës. Një nga këto detyrime është edhe ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ, proces i cili mbikqyret nga Komiteti i Ministrave.

